

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE
“SHFRYTËZIM PËR MINERAL GIPSI”
VENDI “SHKËMBI i ZEKTHIT”, BELËSH.
SUBJEKTI “ALB-DONI” SHPK

Sfond.

Subjekti "ALB - DONI" sh.p.k. është subjekt vendas, i rregjistruar në Q.K.B. me datë 14.05.1999 me NIPT J92705220C dhe, adresë të aktivitetit Elbasan, Belsh, Trojas, Shkëmbi i Zekthit, fshati Trojas, Bashkia Belësh, zona kadastrale nr 3647.

Objekti i aktivitetit të këtij subjekti është (citojmë) : *Kërkim, zbulim, shfrytëzim, eksport-import e përpunim të pjesshëm të mineraleve, blerje e përdorim të lëndës plasëse, tregti me shumicë e pakicë, transport etj. Studime dhe projektme në fushën e gjeologjisë inxhinierike dhe hidrogjeologjisë. Projektme të punimeve gjeologjike e të zbulimit të punimeve minerare të hapjes, përgatitjes për shfrytëzimin e mineraleve dhe të materialeve të ndërtimit. Tregtim me shumicë e pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm. Veprimtari në fushën e ndërtimit etj. Administrator i shoqërisë është z. Saliko Jupa, për periudhën 19.12.2016 deri 19.12.2021*

Subjekti "ALB - DONI" sh.p.k. është i pajisur me :

- i. Leje Mjedisi PN-1747-04-2011, Kodi III.1.B "Shfrytëzim i karrierës së gipsit".
- ii. Leje Shfrytëzimi PN-0858-09-2015, Kodi IV.1.B.2 "Shfrytëzim për mineral gipsi" Vendi "Shkëmbi I Zekthit", Belësh. Koordinatat e zonës janë :

X1 = 45 40 430	X2 = 45 40 610	X3 = 45 40 670	X4 = 45 40 540
Y1 = 44 08 060	Y2 = 44 08 060	Y3 = 44 08 266	Y4 = 44 08 266

Brenda këtyre koordinatave përfshihet një sipërfaqe prej 0.0319 km².

- Rezervta gjeologjike të këtij vendburim minerar janë 290 560 ton.
- Rezervat e nxjerrëshme janë 203402 ton.
- Prodhimi minerar 20000 ton/vit.

Mineralit të gipsit i nxjerrë nga ky vendburim, i përfshirë në zonën kadastrale nr. 3647 do të përdoret si lëndë shtesë në prodhimin e çimentos, për rritjen e markës së saj, etj.

Raporti i paraqitur në vijim synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin në mjedisin e zonës ku punohet dhe më gjërë rreth saj, të projektit të propozuar për zbatim në :

- përdorimin e tokës dhe ndikimet në të,
- ndikimet në florën dhe faunën,
- ndikimet në ujrat sipërfaqësore dhe ato nëntoksore, burimet e ujit, etj.
- ndikimet në ajër nga shkarkimet e gazeve të ndryshëm dhe të pluhurit.
- ndikime në infrastrukturën e zonës.
- ndotjen akustike.
- çdo ndikim social-ekonomik të mundshëm.

Pjesë e rëndësishme e këtij raporti është parashikimin dhe përshkrimi i masave zbutese të ndikimeve të identifikuar dhe analizuar të projektit të paraqitur, me qëllim eliminimin ose/apo zvogëlimin e efekteve negative në mjedis nga shkarkimet e identifikuara me synim përmisimin e cilësisë dhe të qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- ❖ Shqyrtimit të alternativave të ndryshme të zbatueshme brenda fushës së veprimtarisë së projektit të paraqitur.
- ❖ Analizës së faktorëve pozitivë dhe të atyre negative me ndikim në mjedis, duke dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilave bën të mundur reduktimin ose/apo eliminimin e këtyre ndikimeve negative.

Grupi i ekspertëve hartues të këtij raporti kryen mbikqyrjen e terrenit në të gjithë zonën ku zbatohet projekti i paraqitur, duke vlerësuar zbatueshmërinë e tij. Ato kryen vërtetime të ndryshme edhe ndaj treguesve mjedisorë përfshi këtu edhe të biodiversitetit të zonës.

Ato zgjedhën dhe zbatuan metodën e listës – kontrollit, e cila vendos nga njera anë të gjithë burimet e mundshme të ndikimeve negative në mjedis dhe nga ana tjetër, bartësit e këtyre ndikimeve si dhe parashikimin e madhësisë së çdo njerit prej ndikimeve të identifikuar.

Pjesë e këtij raporti është përshkrimi i statusit aktual të territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia dhe hidrogeologjia e rajonit etj.

Ekspertët kanë patur parasysh dy tipare të rëndësishëm të impaktit mjedisor :

- a. Shterimin e burimeve.
- b. Ndotje e mjedisit apo cënimin e treguesve mjedisorë të zonës ku zbatohet projekti.

Vlerësimi i ekspertëve përkatës është se kemi të bëjmë me zbatim të përgjithshëm korrekt të projekteve të shfrytëzimit të karrierës së gipsit, duke treguar një menaxhim të qëndrueshëm të saj. Me zhvillim të qëndrueshëm duhet të kuptojmë kontrollin e ndotjes, përdorimin efiçent të energjive të përdorura, menaxhimin e mbetjeve teknologjike, parandalimin e aksidenteve mjedisore dhe të atyre në punën e shfrytëzimit të karrierës etj.

1. Instalimi dhe aktivitetet e tij.

Subjekti “ALB-DONI” sh.p.k. prej disa vitesh shfrytëzon vendburimin e mineralit të gipsit në karrierën që gjendet në fshatin Trojas të Belshit. Kariera është vënë në shfrytëzim në zbatim të projekteve përkatëse në të cilët janë përcaktuar të gjitha detajet e shfrytëzimit, duke filluar nga lloji i miniers-karrier, rrugët për hapjen dhe hyrjen në të, sheshet e punës, shkallët e karrierës, mënyrat e nxjerrjes së mineralit, mënyrat e transportit, numurin e fuqisë puntore, kohën e punës, ditët e punës në muaj dhe në vit në përputhje me kapacitete prodhuese mujore e vjetore.

a. Vendndodhja e karrierës.

Vendburimi i gipsit “Shkëmbi i Zekthit” pasqyrohet në hartën topografike me shkallë 1:25000 dhe, bën pjesë në planshetën K-34 -112-B-b i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela me koordinatat e kulmeve të lejes minerare të shfrytëzimit.

Nr. i pikës	Y	X
1	44 08 060	45 40 430
2	44 08 060	45 40 610
3	44 08 266	45 40 670
4	44 08 266	45 40 540

Brenda këtyre koordinatave përfshihet një sipërfaqe prej 0.0319 km².

Trualli i kësaj kariere nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi. Ai karakterizohet nga sipërfaqja e çveshur e shkëmbit, e cila është nën ndikimin e agjentëve atmosferik.

Në sipërfaqen e çveshur, nuk ka asnjë element infrastrukture, kjo edhe për faktin se është larg qendrës së banuar, relievit të thyer, mungesës së burimeve ujore, është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e infrastrukurës dhe elementëve të saj.

Kariera gjendet rreth 750 metra larg nga rruga kombëtare Elbasan – Belësh. Kjo rrugë u shërben edhe banorëve të zonës për lëvizjen e tyre si dhe të produkteve bujqësore.

b. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit.

Për shfrytëzimin e këtij vend burimi janë hartuar projektet teknike që janë miratuar nga Agjencia Kombëtare e Burime Natyrore, në bazë të ligjit minerar.

Në vijim po paraqesim disa planimetri për të ilustruar punimet minerare dhe paraqitjen e karrierës gjatë proceseve të shfrytëzimit dhe në fund të tyre.

c. Proçeset kryesore teknologjike të hapjes dhe shfrytëzimit të karrierës.

Sistemi i shfrytëzimit ka filluar me ndërtimin e rrugëve hyrëse në karrierë dhe me hapjen e transeve të rrugëve për të arritur kuotën më të lartë të fushës minerare si dhe, hapjen e transeve prerëse. Rrugët janë hapur në pjesën jugore dhe lindore të karrierës. Rrugët e hapura kanë një gjatësi të përgjithshme prej 600 metrash dhe gjërësi deri 4 metra. Rrugët kanë kanalizime për mbledhjen dhe disiplinimin e rrjedhjes së ujrave sipërfaqësore.

Transhetë janë të hapura në drejtimin lindje-perëndim dhe në trupin mineral-mbajtës në të njëjtin drejtimin lindje-perëndim. Rradha e hapjes së këtyre transheve është nga kuota më e lartë + 190 m, në atë më të ulët + 140 m.

Sheshi depozitimit të sterileve apo mbetjeve të ngurta teknologjike është sistemuar në juglindje të karrierës, në kuotën më të ulët të vendburimit +140 metra.

Sistemi i shfrytëzimit i përdorur në këtë karrierë është ai me shkallë me lartësi maksimale 10 metra.

Elementët teknik të kësaj kariere pasqyrohen në tabelën në vijim.

Elementët e karrierës.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera
1	Thellësia vertikale e karrierës.	m	10
2	Numuri i shkallëve	Nr.	6
3	Gjërësia e karrierës në plan, në pjesën e sipërme të saj do të jetë.	m	100
4	Gjërësia e sheshit në pjesën e poshme të karrierës	m	86
5	Gjatësia e karrierës në pjesën e sipërme.	m	100
6	Gjatësia e karrierës në pjesën e poshme.	m	115
7	Këndi i shuarjes së shkallëve në vartësi të shtrirjes së karrierës është.	Gradë	75
8	Lartësia e shkallëve	m	10
9	Orientimi i transheve të hyrjes është nga lindja drejtë perëndimit		L – P
10	Sipërfaqja e karrierës në plan së bashku me transhetë e hyrjeve.	km ²	0.032

- Rezervta gjeologjike të këtij vendburim mineralar janë 290 560 ton.
- Rezervat e nxjerrëshme janë 203402 ton.
- Prodhimi mineralar 20000 ton/vit.

Proçesi teknologjik i prodhimit të gipsit në kariere është përgjithësisht i thjeshtë. Shfrytëzimi bëhet nga lartë poshtë nga shkalla e parë duke u ulur çdo 10 metra deri në shkallën fundore.

Per realizimin e prodhimit, zbulimit, dhe kryerjen e proçeseve të tjera përgatitore dhe ndihmëse në këtë karrierë punojnë makineritë e pajisjet si më poshtë :

- Një ekskavator me lopatë mekanikë të kundërt, me kapacitet të kovës 1.6 m³.
- Një buldozer.
- Dy automjete transporti me kapacitet 10 m².
- Një kompresor i ajrit të ngjeshur.

Me anën e ekskavatorit kryhen punimet e gërmimit dhe të çvendosjes së pjesëshme të materialeve, në gjatësinë e krahut të tij. Na rastet e pamundësisë së punës së ekskavatorit shkrufti i shkëmbit mineral-mbajtës dëhet me anë të shpërthimit të lëndës plasëse që zakonisht është amonit/dinamit duke përdorur dhe fitilat e kapsollat.

d. Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm.

Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm në karrierë janë dy prej proceseve teknologjike kryesorë në shfrytëzimin e kësaj kariere. Këtyre dy proceseve ju nënshtrohen të gjitha llojet e lëndëve/materialeve të cilat gjenerohen gjatë shfrytëzimit të karrierës duke përbendur këtu, mbulesën e trupit xeheror, mbetjet teknologjike të ngruta apo sterilet si dhe vetë produktin, mineralin e gipsit.

Proçesi i ngarkimit kryhet me anë të ekskavatorit me kovë/lopatë të kundërt me vëllim 1.6m^3 . Transporti i materialeve kryhet me automjete me aftësi transportuese 10m^3 .

Mbetjet teknologjike kanë përbërje mineralogjike të argjilave të tipit argjilite me copra gëlqerori. Ato depozitohen në sheshin përkatës që gjendet në juglindje të karrierës dhe, prej këtej në mënyrë periodike, shkojnë në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Belësh, për mbulimin e tyre. Përdorimi i këtyre mbetjeve teknologjike, është bërë në marrëveshje me strukturat përkatëse të Bashkisë Belësh.

Produkti apo minerali i gipsit i nxjerrë, transportohet dhe sistemohet në dy kontenjerë metalikë të cilët shërbejnë si magazinë. Ai qëndron aty deri në transportin drejtë subjektit blerës që zakonisht janë fabrikat e prodhimit të çimentos.

Brenda teritorit të objektit gjendet edhe një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që punojnë në këtë karrierë.

e. Zonat e rrezikëshme që lidhen me qëndrueshmërinë e shkëmbinjve.

Studimi i kujdesshëm i ndërtimit gjeologjik të këtij vendburimi si dhe eksperiencia disa vjeçare e punës kanë treguar që pjerrësia e shpateve duhet të jetë e tillë që të sigurojë një qëndrueshmëri të tyre. Në formacionet e gipsit këndi i pjerrësisë së shpatit është 48 – 75 gradë kur nuk është prekur nga tektonika. Në rastet kur ka ndodhur ky fenomen, këndi i fërkimit të brendëshëm është 35 gradë. Depozitimet argjilo-copzore janë të stabilizuara nën një kënd prej 22-55 gradë.

- Zona e rrezikëshme e **shkallës së parë**, është kontakti i argjiliteve të kapelës së diapirit me gipsin dhe zonat tektonike –karstike.
- Zona e rrezikëshme e **shkallës së dytë**, është zona ku punohet dhe lihet shkallë në depozitimet argjilore. Këtu mbahet parasysh që të sigurohet një pjerrësi e shkallës prej 20-50 gradë, e cila duhet mbajtur nën kujdes.

- Zona e rrezikëshme e **shkallës së tretë**, është zona që do të lihen shkallët në argjila me material copëzor. Në këtë rast duhet të sigurohet pjerrësi e shkallës nën këndin 25-50 gradë dhe, shkalla duhet të krihet me ekskavator për copat e varura të gëlqerorëve në argjila.

2. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

2.1. Minerali i gipsit

Lënda e parë e këtiv vendburimi është minerali i gipsit i cili është njëkohësisht edhe produkti kryesor i saj.

Formula kimike e gipsit është $\text{Ca}(\text{SO}_4) \cdot 2\text{H}_2\text{O}$. Ngjyra e gjipsit është e bardhë kurse në kristale është pa ngjyrë si xhami.

Mineralet kryesore që takohen në këtë vendburim janë *gipsi* dhe *anhidriti*. Rrallë takohen ndërfitje të dolomiteve, material i imët ranoro-argjilor, etj. të cilët ndikojnë në zbehjen e ngjyrës së bardhë të mineralit. Takohen edhe kristalizime të mineralit të selenit në trajtë folesh dhe xhepush të vegjël.

Të shumëllojshëm janë dhe agregatet e gjipsit, si agregate masive të ngjeshur kokrrizorë, agregate me fije e fletë paralele që quhen selenite, agregat të imët e me ngjyrë të bardhë.

Në disa raste kur gjipsi ngjyroset në gri, të verdhë, të kuqerremtë, të murrme deri në të zezë, shkelqimi është xhamor kurse, në planet e shpetëzimit perlë.

Gjatë nxehjes në temperaturën 220°C gjipsit i largohet uji dhe kthehet në anhidrit. Pjekja e gipsit në temperaturën 400°C e kthen atë në gips të pjekur, sepse humbet vetinë për t'u lidhur me ujin.

Komponenti i dobishëm kryesor në përmbajtjen e mineralit luhatet nga 77 % deri 84 % $\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ (CaO 34-35 %; SO_3 luhatet nga 36-39 %).

Komponentet e tjere si SiO_2 , MgO, Al_2O_3 etj. janë në përqindje të papërfillëshme dhe brenda tolerancave të lejuara.

2.2. Energjitë e përdorura.

Për kryerjen normale të kësaj veprimtarije është e nevojshme përdorimi i energjive të përshkruara në vijim:

a. Energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjeteve të punës, rrugëve etj. Fuqia elektrike e instaluar në këtë karrierë është rreth 25 kWh.

b. Furnizimi me ujë.

Uji nuk është pjesmarrës në proceset teknologjike që zhvillohen në këtë karrierë për nxjerrjen e mineralit të gipsit. Ai përdoret kryesisht për plotësimin e nevojave humane.

c. Përdorimi i lëndës djegëse, naftë.

Të gjitha mjetet që punojnë në këtë karrierë punojnë me lëndë djegëse naftë. Ajo blihet në subjekte të licencuar për magazinimin dhe tretimin e saj. Konsumi i naftës shkon mesatarisht në rreth 350 litra/muaj.

3. Burimet e shkarkimeve nga instalimi.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të nxjerrjes së mineralit të gipsit në karrierë të hapur, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

3.1. Shkarkime në ajër.

Zhvillimi i aktivitetit të nxjerrjes së mineralit të gipsit shoqërohet me shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurit.

Në përbërje të gazeve që shkarkohen janë: bioksidi i squfurit (SO_2), monoksidi i karbonit (CO), gazi karbonik (CO_2), oksidi i azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është puna e motorëve që punojnë me lëndë djegëse kryesisht me naftë.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të ngarkimit të mbetjeve dhe produktit të gipsit, lëvizjes së mjeteve gërmuese e çvendosëse të materialeve brenda karrierës si dhe të mjeteve transportuese.

Gaze dhe veçanërisht pluhura shkarkohen gjatë procesit të plasjeve, proces që përdoret në rastet e shkriftimit të mineralit të gipsit.

3.2. Shkarkime në tokë.

Në tokë kemi shkarkim të sterile që dalin gjatë punimeve të hapjes së rrugëve dhe transheve, punimeve për heqjen e mbulesës argjilore si dhe të sterileve që dalin gjatë kryerjes së procesit të nxjerrjes së mineralit të gipsit. Sasia e përgjithëshme e sterile është në raport gati të barabartë (1 : 1) me sasinë e mineralit të gipsit të prodhuar.

E gjithë sasia e sterilite të kriuar gjatë zhvillimit të veprimtarisë sistemohet në pjesën jugolindore të karrierës, në kuotën më të ulët të saj + 140 metra.

Nga vrojtimi në teren, konstatohet se në infrastukturën e ngritur si psh në rrugët hyrëse në karierë dhe në tranшетë prerëse për në shkallët e shfrytëzimit ka problem të rrëshqitjes së tokës. Në pjesën që kalon në formacionet e “kapelës së Diapirit” ka rrëshqitje nga skarpitet e rrugës.

3.3. Shkarkime në sipërfaqet ujore.

Në zonën ku përfshihet kariera e gipsit “Shkëmbi i Zekthit” fshati Trojas nuk gjenden burime uji. Në anën jugore të kësaj karriere gjendet një hinkë karstike e cila mbledh dhe çvendos të gjithë ujrën sipërfaqësore të zonës, kryesisht ujrave që shoqërojnë rreshjet. Karakteristikat e tokës argjilo-copëzore të kësaj zone kanë një koeficient të lartë filtrimi, duke bërë të kështu mos krijimin e pellgjeve e ligatinave në këtë zonë.

Proçeset teknologjike që zhvillohen në këtë karierë nuk kanë të nevojshëm përdorimi i ujit, tregues teknik që dëshmon se këtu uji është i pranishëm gjatë reshjeve.

Ujrat sipërfaqësore që rrjedhin gjatë shpateve të karrierës mbartin me vete grimca pezull të material përbërë të saj, deluvjoneve.

3.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjenerimi i zhurmave ndodh gjatë proçeseve të ngarkimit të produktit/gipsit si dhe të sterileve në mjetet e transportit si dhe gjatë punës së mjeteve gërmuese e transportuese. Gjenerim të zhurmave kemi edhe gjatë plasjes lëndëve plasëse të cilat përdoren për shkruftimin e mineralit të gipsit.

4. Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes.

Zona e Belshit apo Dumrea, është një krahinë kodrinore në pjesën qendrore të Shqipërisë. Ajo ka pamjen e një pllaje me kodra e lugina që vijnë njëra pas tjetrës të cilat rrallë e kalojnë lartësinë 200 m mbi nivelin e detit. Vendodhja në kryqëzimin e rrugëve që lidhin fushën e Elbasanit me fushën e Myzeqesë, luginën e Devollit me luginën Shkumbinit dhe malësisë përreth (Verce, Sulovë, Darsi, Krrabë) ka favorizuar ndërveprimin e kulturave dhe ngritjen e vendbanimeve historike. Në këtë zonë ndodhen shumë liqene natyrorë si: liqeni i Belshit, Seferanit, Merhojës, Çestijes, Degës, Dorbit, Plevicës, Civilës etj.

4.1. Përshkrim të faktorëve klimatikë.

Dumrea bën pjesë në zonën e ulët bregdetare të territorit të Shqipërisë dhe ka klimën e saj karakteristike.

Sasia e rreshjeve luhatet tek ato mesatare shumëvjeçare të zonës me rreth 900 mm shi në vit dhe janë të shpërndara në mënyrë të çrregullt, në rreth 90 ditë me reshje. Rreth 70% e rreshjeve i takojnë muajve Tetor-Maj.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit është rreth 15 °C. Muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare 2.8 °C; muaji më i nxehtë është Gushti, me temperaturë mesatare 22 ÷ 25 °C.

Zona në të cilën gjendet kariera është nën ndikimin e erërave që fryjnë nga jugu dhe të atyre që fryjnë nga lindja. Erërat që fryjnë në drejtim nga veriu dhe perëndimi janë gati të pandjeshme dhe kjo, për shkak se kariera ka rënie të relievit në jug dhe lindje.

Shpejtësia mesatare e erës në dimër është rreth 2.1 m/sek; në verë e në vjeshtë është rreth 1.2 m/sek.

4.2. Përshkrim i përgjithshëm i gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë në zonën e projektit.

Nga përbërja gjeologjike Dumrea përfaqëson në vetvete një formacion origjinal, që nuk takohet në asnjë pjesë tjetër të territorit të Shqipërisë. Dumrea është një rajon karstik, formacionet bazë të të cilit janë gipset, dolomitet, kripërat e gurit dhe tufi vullkanik. Duke udhëtuar nëpër zonën e Dumresë njeriu ndeshet me shfaqjet e ndryshme e të shumta të fenomenit të karstit. Në të gjithë sipërfaqen e saj, veçanërisht në pjesën jugore të saj vihen re mjaft hinka karstike apo gropa fundosjeje. Në fundin e këtyre hinkave takohen shpesh poret thithëse, nëpërmjet të cilave ujrë sipërfaqësorë zhduken në thellësi të tokës. Një pore e tillë vihet re në fundin e masivit të malit të Gradishtës ku humbasin ujrë e turbullitë. Në pjesën jugore të saj ndeshen dhe lugina qorre ku uji i tyre humbet në thellësi të tokës.

4.3. Ujrë sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Në zonën ku gjendet kariera “Shkëmbi i Zekthit” nuk gjenden burime të ujrave nëntoksore si dhe ujrë sipërfaqësorë të tillë si përrenj, ujë mbledhës etj.

Por, në teritorin e Dumresë ka shumë liqene natyrorë që janë formuar si rezultat i fenomeneve karstike që kanë ndodhur dhe që vazhdojnë dhe sot në përmasa më të vogla. Këto liqene shfrytëzohen për peshkimin dhe vaditjen e kulturave bujqësore. Ata kanë madhësi dhe thellësi të ndryshme. Sipërfaqja e tyre e përgjithshme është rreth 640 ha. Aftësia ujëmbajtëse 26 milion m³ ujë. Madhësia e liqeneve shkon nga 500 m² deri në 968.000m² (liqeni i Çestijes). Thellësia shkon nga 5m deri në 61m (liqeni i Merhojës). Janë liqene kryesisht me regjim shiu, që mbushen nga reshjet që bien.

Disa nga liqenet me piktoreskë të Dumresë janë: Liqeni i Belshit, Merhojes, Seferanit, Çestijes, Degës, Liqeni i Kuq, Paraskës dhe i Marinzës etj. Bukuritë e këtyre liqeneve kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj të cilët mund të shfrytëzohen edhe për turizëm.

4.4. Bimesia.

Kjo zonë ka qenë e pyllëzuar me pyje dushku, drize, shkozë, frashër dhe me pemë frutore të cilët i jepnim asaj një bukuri të rrallë. Pas formimit të Kooperativave Bujqësore në vitin 1956-1957 kjo zonë ju nënshtrua shpyllzimeve pa kriter të pyjeve, të prerjes e shkëlqeve masive të pemëve në troje për t'i kthyer ato në toka buke. Pas shembjes së sistemit komunist (viti 1991) e deri sot po rigjenerohen mjaft pyje dushku, si dhe po gjelbërohet e gjithë zona për t'a kthyer atë siç ka qenë. Gjithashtu fermerët kanë mbjellë masive me vreshta, ullishta e pemë të ndryshme frutore dhe dita ditës Dumrea po gjelbërohet.

Liqenet kanë florë të pasur, kanë zambakë (lekoi i verdhë dhe lekoi i bardhë, që ndodhen në liqenin e Seferanit, Degës, Çerragës).

4.5. Fauna e zonës dhe e vend-burimit të gipsit.

Në zonën e Belshit takohet një larmi e madhe e gjallesave të llojeve e popullateve përkatëse. Këtu takohen, lloje të ndryshme kashësh të egra si dhe të atyre të mbarështruara nga banorët e zonës. Të njëjtat përfundime mund të thuhen edhe për shpendët si dhe popullatat e gjallesave që gjenden në ujrat e liqeneve të Dumresë.

Ne Dumre takohet lepuri i egër, urithi, miu i vogël i arave dhe, në stinën e ftohtë edhe dhelpira. Banorët e zonës mbarështrorjën kryesisht lopën dhe delen.

Ndër shpendët që takohen në zonë, mund të përmendim trumcakun, thëllëzën, dallëndyshet, pëllumbin, etj. Banorët mbarështrorjën pulat dhe gjelin e detit.

Gjithashtu në të takohen insekte, zvarranikë dhe shumkëmbësja karakteristike të zonës.

Liqenet janë të pasur dhe me peshq kryesisht krapi natyror, krapi i kultivuar, ballgjëri, amuri etj, dhe në disa liqene rritet dhe ngjala si specie endogjene.

Në liqenet e Dumresë rriten rosat, dhe patat e egra, bajzat të cilat janë shpend shtegtarë.

4.6. Përdorimi i tokës në zonën e projektit.

Teritori i Shkëmbit të Zekthit, nuk është në përdorim të banorëve të zonës për t'u trajtuar si kullotë, tokë bujqësore apo për mbjelljen në të, të pemëve frutore apo pemëve të pyllit. Kjo edhe për shkak të karakteristikave cilësore të tokës.

Zona rrethuese e Shkëmbit të Zekthit, është pothuajse tërësisht në përdorim të banorëve të kësaj zone. Ajo është e sistemuar dhe e shfrytëzuar kryesisht si tokë bujqësore duke mbjellë në të bimë të arave si dhe duhan. Një pjesë e vlerësueshme e saj këto vitet e fundit është mbjellë me ullinj e drufrutorë të zonës si dhe me rrush të varieteteve të ndryshme.

4.7. Cilësia e ajrit në zonë.

Dumreja apo rajoni i Belshit, karakterizohet si një zonë tërësisht rurale në të cilën mungojnë linjat teknologjike të cilat mund të influencojnë në treguesit e cilësisë së ajrit. Në vende të caktuara ndeshemi me zhvillim procesesh që gjenerojnë shkarkime të elementëve ndotës në

ajër, por ato janë të rrallë, me kapacitete relativisht të vogla dhe shkarkimet e tyre janë periodike.

Kjo zonë nuk është e përfshirë në procesin e monitorimit të ajrit nga Agjensia Kombëtare e MJedisit.

4.8. Niveli i zhurmave në zone.

Të njëjtat vlerësime vlejné edhe për gjenerimin e zhurmave në këtë zonë rurale. Gjenerimi i zhurmave është sporadik e i përkohshëm në linja të përpunimit të mermerit, të përpunimit të drurit dhe në rastin konkret të shfrytëzimit të kësaj kariere.

Kjo zonë nuk është e përfshirë në procesin e monitorimit të ajrit nga Agjensia Kombëtare e MJedisit.

4.9. Administrimi i mbetjeve në zonën e projekti.

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve apo qendrave urbane, shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve kryhet nga kompani private të menaxhimit të mbetjeve, të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë. Në shumicën e bashkive të vendit, procesi i menaxhimit të mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri në venddepozitim si dhe ngjeshjen dhe mbulimin e tyre me argjila.

Bashkia Belësh ka përcaktuar një vend të depozitimit të mbetjeve urbane të zonës që administron. Mbetjet e depozituara në vendin e caktuar mbulohe me mbetjet e tipit argjilor të përzierë me copra gipsi që dalin gjatë shfrytëzimit të karrierës së gipsit. Transporti i materialit argjilor nga kariera në vendin e depozitimit të mbetjeve urbane bëhet nga subjekti “ALB-DONI” sh.p.k.

4.10. Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti.

Shfrytëzimi i mineralit të gipsit në karierë në vendin e quajtur “Shkëmbi i Zekthit” gjendet në fshatin Trojas të Bashkisë Belësh. Nga ana administrative, në Bashkinë Belësh ndodhen 5 Njësi Administrative (ish Komuna) dhe një Bashki në përbërje të të cilave janë 35 fshatra. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 268 km katrorë dhe një popullsi prej 33.969 banorë me një dendësi 142 banorë/km katrorë.

Popullsia e kësaj zone merret me kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si grurë, misër, duhan, perime, vreshtari e frutikulturë pasi zona e Dumresë ka kushte shumë të përshtatëshme klimatiko-tokësore për kultivimin e tyre. Gjithashtu, kjo popullsi mbarshtron dhe bagëti të trasha dhe të imta, derra, shpend dhe bletë, për të siguruar produkte për nevojat e veta dhe një pjesë për shitje.

Një pjesë e vogël e popullsisë së kësaj zone merret edhe me akuakulturë e peshkim, linja të prodhimit të vajit, përpunimit të drurit, të mermerit, me tregti të mallrave industrial e ushqimore, shërbime në bare e restorante etj.

5. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis.

Ekspierienca disa vjeçare e shfrytëzimit të karrierës së gipsit në vendin e quajtur “Shkëmbi I Zekthit” ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave, probleme të erozionit të tokës si dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta apo sterile.

5.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Në ambjentet e punës së kësaj kariere ndodhin shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurave për aq kohë sa zhvillohen :

- punimet e hapjes së rrugëve hyrëse dhe të trasheve prerëse,
- heqjes/çvendosjes së mbulesës së trupit mineral mbajtës,
- shfrytëzimit të mineralit,
- çvendosjes së sterileve dhe mineralit brenda karrierës,
- proceseve të ngarkimit/shkarkimit të mjeteve të transportit dhe të lëvizjes së tyre.

Gazet që shkarkohen kanë në përbërje të tyre bioksid të squfurit (SO_2), monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO_2), oksid të azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është puna e motorëve të mjeteve gjermuese, ngarkuese e transportuese që punojnë me lëndë djegëse kryesisht me naftë.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të ngarkimit të mbetjeve dhe produktit të gipsit, lëvizjes së mjeteve gjermuese e çvendosëse të material brenda karrierës si dhe të mjeteve transportuese.

Gaze dhe veçanërisht pluhura shkarkohen gjatë procesit të plasjeve, proces që përdoret në rastet e shkriftimit të mineralit të gipsit.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjenerimi i zhurmave është gjithashtu një dukuri e përkohëshme e cila është e pranishme gjatë kohës së punës së mjeteve motorrike që punojnë në këtë karrierë. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë kohës së punës së këtyre mjeteve janë të niveleve 76 – 87 LeqdB (A).

c. Probleme të erozionit të tokës.

Nga vrojtimi në teren, konstatohet se në infrastukturën e gritur si psh në rrugët hyrëse në karrierë dhe në tranшетë prerëse për në shkallët e shfrytëzimit ka problem të rrëshqitjes së tokës. Në pjesën që kalon në formacionet e “kapelës së Diapirit” ka rrëshqitje nga skarpitet e rrugës.

d. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta apo sterileve.

Në tokë kemi shkarkim të sterile që dalin gjatë punimeve të hapjes së rrugëve dhe tranшеve, punimve për heqjen e mbulesës argjilore si dhe të sterileve që dalin gjatë kryerjes së procesit të nxjerrjes së mineralit të gipsit. Sasia e përgjithëshme e sterile është na raport gati të barabartë (1 : 1) me sasinë e mineralit të gipsit të prodhuar.

E gjithë sasia e sterilite të krijuar gjatë zhvillimit të veprimtarisë sistemohet në pjesën jugore të karrierës, në kuotën më të ulët të saj + 140 metra. Këto mbetje teknologjike të ngurta, shkojmë me mjetet e vetë subjektit në vendin e depozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Belësh dhe, përdoren atje për mbulimin e këtyre mbetjeve urbane. Kjo është bërë në bazë të një marrëveshje me administratën e kësaj bashkije.

e. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Sipërfaqja e truallit në të cilën bëhen punime për shfrytëzimin e gipsit, është kurrizore në formën e një kodre. Aktiviteti shfrytëzimit me karrierë ka prekur tashmë prej disa vitesh radhazi peizazhin dhe topografinë e saj në pjesën jugore dhe atë lindore të Shkëmbit të Zekthit.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor ka ndodhur gjatë hapjes së karrierës dhe ndodh gjatë shfrytëzimit të shkallës së parë dhe të dytë të saj duke përbërë kështu një faktor negativ. Ky dëmtim mund të vlerësohet i pavlerësueshëm duke u nisur nga fakti që ky shkëmb është pothuajse i çveshur nga bimësia.

Zbatimi i programe të rehabilitimit truallit të karrierës dhe në afërsi të tij, gjelbërimin me bimë e pemë që rriten në këtë zonë, gjatë shfrytëzimit dhe në mbyllje të aktivitetit, do të përmirësojë dukshëm peizazhin dhe topografinë e zonës.

f. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Zona që shfrytëzohet nuk ka bimësi dhe është në përgjithësi e çveshur, ku pjesën më të madhe të sipërfaqes së saj e zë çfaqja e shkëmbit.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804. dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për t’u shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

g. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Aktiviteti i shfrytëzimit të mineralit të gipsit kryet larg zonave të banuara, në shpatin jugor dhe atë lindor të Shkëmbit të Zekthit.

Zbatimi i projektit gjatë këtyre viteve nuk ka kërkuar çvendosje apo ndryshime të tjera të zonave të banuara në afërsi të tij apo/ose krijimin e zonave të reja banimi.

Aktiviteti i shfrytëzimit të këtij vendburimi të mineralit të gipsit bëhet në një zonë tepër të kufizuar në krahasim me sipërfaqen dhe popullsinë e rajonit të Belshit. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokëse shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e më sipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që do të parashikohen dhe zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të nxjerrjes së mineralit të gipsit nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujerave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

Shfrytëzimi i burimit natyror për nxjerrjen e mineralit të gipsit do vijojë të bëhet sipas projekteve përkatëse të miratuara në kohën dhe sasinë e parashikuar.

5.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si :

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës si dhe të truallit/tokës që shfrytëzohet.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloj ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivitet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimesionet hapsinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim. p.sh. ndikimi në tokë nga shfrytëzimi i vendburimit të mineralit të gipsit në karrierë është një ndikim përgjithësisht i përcaktuar i cili mund të vlerësohet lehtësisht.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimesionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkoshëm.

Në rastin tonë, shfrytëzimi i vendburimit të mineralit të gipsit është një ndikim i përhershëm që shkon deri në nxjerrjen e të gjithë rezervës minerare të mundshme, të përcaktuar në afatin e lejes minerare.

Ndërsa pothuajse të gjithë ndikimet e tjera negative në mjedis si psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj. janë ndikime të përkoshëme.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimi të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të shfrytëzimit të mineralit të gipsit në karrierë të hapur janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

6. Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme.

Shfrytëzimi i karierave të hapura për nxjerrjen prej tyre të minerale metalorë ose jo të tilla, është një praktikë e njohur dhe e zbatuar gjërësisht në vendin tonë. Po kështu duhet pranuar se, egziston një numur relativisht i madh njerëzish të cilët kanë njohuritë e duhura teorike dhe praktike në këtë fushë, duke përfshirë këtu personelin inxhinjer dhe atë teknik por edhe punonjës të punës së drejtpërdrejtë në këtë sektor.

Kjo njohje dhe eksperiencë është një bazë e rëndësishme jo vetëm për të njohur dhe vlerësuar ndikimet e mundshme në mjedis por, çka është më e rëndësishmja, për të përcaktuar ndërhyrjet e duhura teknike dhe administrative në minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedisin ku zbatohet projekti.

Ndikimet e identifikuar gjatë shfrytëzimit të mineralit të gipsit, përgjithësisht nuk kanë shtrirje të madhe fizike, për shkak të pozicionit gjeografik të objektit që shfrytëzohet, trëndafilin të erërve në këtë zonë, llojit dhe sasisë së elementëve ndotës së mjedisit, përkohshëmrisë së gjenerimit të ndotësve etj.

Subjekti ALB-DONI sh.p.k ka disa vite që shfrytëzon mineralin e gipsit në karrierën e hapur në vendin e quajtur “Shkëmbi i Zekthit”, duke krujar kështu një eksperiencë të mjaftueshme jo vetëm për të njohur dhe vlerësuar ndikimet negative në mjedis por edhe për të përcaktuar e hartuar programe pune, zbatimi i të cilave çon në minimizimin apo/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

Duke vlerësuar këtë eksperiencë në vijimsi ne do të paraqesim disa rekomandime, zbatimi në praktikën e përditëshme të punës, do bëjë të mundur **parandalimin dhe minimizimin deri në maksimumtë të ndikimeve negative në mjedis.**

- Dheu që del gjatë hapjes së rrugëve hyrëse duhet të sistemohet në një pjesë të truallit të brendshëm të karrierës me qëllim që të përdoret për qëllime rehabilitimi dhe mbushieje të zonave të caktuara të karrierës.
- Gërmimet duhet të kryhen vetëm sipas projektit dhe duke repektuar kushtet teknike të përcaktuara në projekt.
- Duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen vazhdimisht kanalet e hapura për disiplinimin e ujrave të rreshjeve të shiut me qëllim parandalimin e erozionit në zona të caktuara si dhe ndotjen e ujrave nga deluvioneve.
- Duke njohur trëndafilin e erërave të zonës ku gjendet karriera, duhet të mos realizohen punime në karrierë apo të kufizohet në maksimum kryerja e tyre gjatë kohës së vlerave maksimale të erëve që fryjnë nga jugu dhe të atyre që fryjnë nga lindja. Konkretisht, erët që fryjnë nga jugu janë më të fuqishme gjatë stinës së verës në mesditë (ora 13 deri 170 ndërsa, në dimër këto erëra janë më të fuqishme në mëngjes.
- Lëvizja e mjeteve brenda karrierës duhet të bëhet vetëm në rrugët e hapura brenda saj.

- Në stinën e thatë të vitit mund të përdorim uji për lagien e rrugëve të brendëshme të karrierës.
- Të gjitha mjetet do të kontrollohen periodikisht në pikat e kontrollit të specializuara dhe të liçesuara. Eliminimi i difekteve të mundëshme të rastit duhet të bëhet në vendin e caktuar brenda objektit.
- Furnizimi i mjeteve me karburat duhet të kryhet në pikën më të afërt të karburantit ose në vendin e përcaktuar brenda teritorit të këtij objekti.
- Largimi i sterileve dhe mbetjeve teknologjike të ngruta duhet të bëhet në kohën e duhur dhe sistemimi i tyre duhet të jetë i kujdeshëm në vendin e përcaktuar brenda teritorit të objektit. Po kështu duhet të jetë i organizuar dhe disiplinuar largimi i këtyre mbetjeve të ngruta teknologjike nga objekti, në vendin e depozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Belësh.
- Transporti i produktit/gipsit nga objekti në drejtim të subjekteve që e përdorin atë duhet të bëhet me mjete të përshtatëshme e të mbulura me mushama.
- Mbetjet urbane të krijuara gjatë veprimtarisë së karrierës duhet të sistemohen në një vend të përcaktuar brenda saj dhe të largohen në mënyrë periodike në vendet e përcaktuara nga Bashkia Belësh.

Në tabelën në vijim, pasqyrohen, llojet e ndikimeve të identifikuara, burimi apo shkaku i tyre, pasojat e drejtpërdrejta në mjedis, kohëzgjatja e ndikimit si dhe ndërhyrjet e mundëshme për parandalimin apo zvogëlimin e ndikimit në mjedis.

Nr.	Ndikimi i mundëshëm	Burimi/shkaku i zhvillimit	Pasojat në mjedis.	Kohëzgjatja e ndikimit.	Ndërhyrjet e mundëshme për parandalimin apo zbutjen e ndikimit.
1	Ndikime në tokë				
	Hapja e rrugëve hyrëse dhe transheve prerëse.	Proçese përgatitor për nxjerrjen e mineralit të gipsit.	Ndryshojnë parametrat dhe pamja fizike e truallit.	Mbetëse ose/apo të përherëshme.	Sistemimi i argjilave dhe mbetjeve teknologjike në vendin e caktuar brenda teritorit të objektit.
	Depozitim i sterileve	Proçeset e nxjerrjes së mineralit të gipsit	Epozitim i përkohshëm i sterileve nuk ndryshon treguesit cilësor të truallit ku ato vendosen.	Mbetëse ose/apo të përherëshme.	Të bëhet në vendin e caktuar brenda teritorit të objektit. Të largohen periodikisht në vendin e caktuar nga Bashkia Belësh.
	Derdhja e pakontrolluar e karburantit dhe vajrave nga mjetet e punës.	Ndodhja e difekte të papritura në mjetet e punës ose/apo kryerja e veprimeve jokorrekte të furnizimit të mjetit me karburant dhe vaj, në ambjentin ku ai punon.	Ndotje e truallit duke ndikuar në treguesit cilësor të tij.	Ndotje e përkohëshme e cila reabilitohet duke ndërhyrë menjëherë në pastrimin e truallit të ndotur.	Të bëhet kontroll teknik si dhe kryerja e shërbimeve të nevojshme periodike të mjeteve në vende të përcaktuara.
2	Ndikime në ajër.				
	Shkarkimi i gazeve nga mjetet që punojnë në karrierë.	Gaze që dalin gjatë djegies së naftës, nga motorrët e mjeteve.	Ndotja e ajrit në zonën ku punojnë këto mjete.	Ndotje e përkohëshme e cila, ndalon sapo ndalon puna e këtyre mjeteve.	Të mos punojnë mjete me problem teknike. Të përdoren lëndë djegëse me tregues cilësor brenda standarteve përkatëse.
	Shkarkim i pluhurave.	Pluhuri shoqëron proçeset e gërmimit, të çvendosjes, të transportit dhe të ngarkim/shkarkimit të sterile dhe mineralit të gipsit.	Ndotja e ajrit në zonën e karrierës.	Ndotje e përkohëshme e cila, ndërpritet sapo përfundojnë proçeset që gjenerojnë pluhurin.	Në raste të përcaktuara të përdoret proçesi i lagies me ujë. Mjetet të lëvizin në rrugët e përcaktuara.

					Mjetet të jenë të mbuluara memushama.
	Emetimi i zhurmave.	Zhurmat gjenerohen nga puna e makinerive që punojnë në karrierë.	Ndotje akustike e zonës ku punohet dhe më gjërë.	Ndotje e përkohëshme e cila ndërpritet sapo ndalojnë punën makineritë që e gjenerojnë zhurmën.	Mjete që emetojnë zhurma duhet të jenë në gjendje teknike normale. Ato duhet të punojnë në periodha kohe të përcaktuar për të frenuar ndikimin e ndotjes akstike.

7. Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur.

Në rastin tonë konkret nuk mund të analizojmë alternativa të mundëshme për zgjedhjen e vendit të zhvillimit të veprimtarisë së nxjerrjes së mineralit të gipsit për dy arsye thelbësore:

- i. Pozicionit gjeografik të ndodhjes së vendepozitimit të mineralit të gipsit.
- ii. Egzistencës së kësaj veprimtarije prej disa vitesh.

Lidhur me instalimin e teknologjisë së përdorur duhet të themi se është një teknologji e njohur dhe e zbatuar jo vetëm në nxjerrjen e mineraleve jo metalore apo edhe të atyre metalore në vendin tonë dhe në vende të tjera.

Zbatimi në praktikë i proceseve teknologjike të përcaktuar në projektet përkatëse, kërkon një numur relativisht të kufizuar makinerish e pajisjes e konkretish, ekskavator me zinxhir ose goma, buldozer, automejte transporti, mjete për shpimin e birave etj. Numuri i këtyre mjeteve është i kufizuar nga një deri në maksimum dy apo tre si janë mjetet e transportit. Janë mjete standarte të cilat janë lehtësisht të manovrueshme dhe që mirëmbahen pa shumë probleme.

8. Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme).

Shfrytëzimi i vendburimeve mineral-mbatëse në kariera të hapura e konkretisht të mineralit të gipsit shoqërohet me krijimin e një sasive të vlerësueshme të mbetjeve të ngurta teknologjike, në të cilat përfshihen kryesisht argjilat dhe coprat e gipsit. Këto mbetje teknologjike dalin kryesisht gjatë kryerjes së punimeve të heqjes së mbulesës, hapjes së rrugëve hyrëse, tansheve prerëse por edhe gjatë nxjerrjes së mineralit të gipsit. Nga projekti teknologjik i shfrytëzimit të kësaj kariere shikohet se rezerva gjeologjike e mineralit të gipsit është 290 560 ton, ndërsa rezerva e nxjerrëshme është 203402 ton pra, mund të nxirret rreth 70 % e rezervës gjeologjike. Nga kësaj përvoja e disa vjeçare e nxjerrjes së mineralit të gipsit nga kjo karrierë rezulton se kemi një raport gati të barabartë sasi ndërmjet mineralit të gipsit të nxjerrë (produktit) dhe mbetjeve teknologjike të krijuara. Sigurisht që ky raport është teknikisht i justifikuar duke patur parasysh kryerjen e volumeve të punës për heqjen e mbulesës dhe hapjen e pjesëve më kryesore të rrugëve hyrëse.

Në vijmë të shfrytëzimit të vendburimit, sasia e materialit steril vjen duke i zvogëluar për arsye se tashmë kemi punime të drejtpërdrejta në trupim mineral mbajës.

Subjekti "ALB-DONI" sh.p.k. në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë Belësh ka gjetur një fushë përdorimi të argjilave e sterile që ai gjeneron gjatë shfrytëzimit të karrierës. Këto mbetje teknologjike përdoren për mbulimin e mbetjeve urbane të depozituara e trajtuara nga kjo bashki.

9. Masat për përdorimin eficient të energjisë.

Veprimtaria e nxjerrjes së mineralit të gipsit kërkon përdorimin e energjisë elektrike dhe kryesisht të energjisë që fitohet nga djegia e naftës.

Energjia elektrike ka një përdorim të kufizuar në këtë veprimtari kryesisht, në ndriçimin e ambjenteve të punës, zyrave, rrugëve të brendëshme etj. Shfrytëzimi i vendburimit bëhet jo në mënyrë të vazhdueshme i diktuar nga kërkesat e tregut. Kjo bën që të punohet në ditë të caktuara dhe kryesisht gjatë orëve të ditës. Pajisjet konsumatore të rrymës elektrike janë të tipit standart dhe lehtësisht të kontrollueshme për regjimin normal të punës së tyre duke garantuar një koeficient të lartë të përdorimit të rrymës elektrike.

Lënda djegëse e tipit diezel/naftë përdoret për punën e mjeteve të rënda si ekskavator, buldozer dhe mjete të transportit. Puna e këtyre mjeteve është periodike dhe e kondicionuar nga kapacitetet e prodhimit të kërkuar. Mirëmbajtja e vazhdueshme teknike e këtyre mjeteve është kusht thelbësor për konsum brenda standarte teknike të lëndës djegëse gjatë punës së tyre.

10. Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

10.1 Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Egziston një rrisht i vlerësuar gjatë zhvillimit të proçeve teknologjike që bëjnë të mundur nxjerrjen e mineralit të gipsit në karrierë të hapur. Rreziku i ndodhjes së aksidenteve është i mundur në proçeset e nxjerrjes/rrëzimit të gipsit, gërmimit, ngarkimin dhe transportit të tij dhe të mbetjeve të ngurta teknologjike, etj. e në mënyrë të veçantë gjatë proçesit të mbushjes së birave me lëndë shpërthyesë e kryerjes së proçesit të plasjes.

Puna në këtë karrierë organizohet e drejtohet nga Drejtuesi teknik i karrieres që është Ing. Miniere. Inxhinjeri bën vazhdimisht e në mënyrë periodike instruksionin teknik të punëtorëve dhe në veçanti të atyre që merren me lëndët plasëse, mbi rregullat e kryerjes së punës parrezik. Punonjësit instruktohen për njohjen e kërkesave teknike të projektit që zbatohet për shfrytëzimin e karrierës dhe krahas saj edhe për kryerjen e çdo operacioni pune pa rrezik të dëmtimit të shëndetit të tyre apo siç njihet zakonisht për rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë.

Ky instruktim bëhet mbështetur në rregulloret përkatëse të hartuara e të miratura, pjesë të veçanta të të cilave janë të vendosura në vende të dukëshme brenda teritorit të objektit.

Në këtë objekt minerar të shfrytëzimit të mineralit të gipsit me kariere, punonjësit e ri, instruktohen teorikisht dhe jo më pak se dy javë mbikqyren në praktikën e veprimtari të tyre në vendin e punës.

Për të bërë të mundur dhënien e menjëherëshme të ndihmës së shpejtë në rastet e aksidenteve të mundëshme karriera ka edhe një ambient të veçantë në të mbahet kutia e ndihmës së shpejtë.

10.2 Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Subjekti ka hartuar një plan të detajuar në të cilin përcaktohen procedurat që do të zbatohen më ndërprerjen e aktivitetit në përfundim të afatit të përcaktuar të lejës minerare. Në këtë plan janë përfshirë :

- i. Sistemimi i sheshit të depozitimit.
- ii. Drejtimi i ujrave sipërfaqore.
- iii. Mbyllja e punimeve ku përfundon aktiviteti mineral.
- iv. Depozitimi, sistemimi dhe monitorimi i sterileve në zbatim të projektit të miratuar.
- v. Gjelbërimi e pyllëzimi, për të rritur sipërfaqet e gjelbëruara.

11. Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Subjekti "ALB-DONI" sh.p.k. ka kryer në vijimsi procesin e monitorimit të ndikimeve në mjedis nga zhvillimi i veprimtarisë së nxjerrjes së mineralit të gipsit. Qellimi i monitorimit mjedisor gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije është që të sigurohen të dhëna të vlerësueshme, analizimi i të cilave dëshmon nëse operimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore të përcaktuara për zhvillimin e kësaj veprimtarije si dhe, për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm. Proçesi i monitorimit është zhvilluar në drejtim të :

- a. Monitorimit të ujrave që rrjedhin në sipërfaqen e karrierës, stoqet dhe sheshet e depozitimit të mbetjeve etj.
- b. Monitorimit të gazeve e pluhurave të shkarkuar apo monitorim të cilësisë së ajrit.
- c. Monitorimit të zhurmave të gjeneruara gjatë punës në karrierë.
- d. Monitorimin e mbetjeve teknologjike të krijuara.
- e. Monitorimi të çfaqjes së fenomenit të erozionit për parandalimin e tij dhe marrjen e masave përkatëse për eliminimin e pasojave.
- f. Riaftësimin e zonave të shfrytëzuara për të mos humbur vlerat fillestare fizike e gjeologjike.

Në vijim po pasqyrojmë rezultate të dala nga kryerja e monitorimit gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije.

a. Shkarkimi i gazeve dhe pluhurit.

Nr	Elementi ndotës.	Vlera e standartit.	Tipi i standartit.	Vlera e matur.
1	Dyoksid i squfurit (SO ₂).			
	Mesatarja vjetore arithmetike	60 µg/m ³	Primare	50 µg/m ³
	Mesatarja vjetore arithmetike	35 µg/m ³	Sekondare	52 µg/m ³
	Mesatarja 24 orëshe	120 µg/m ³	Primare	31 µg/m ³
	Mesatarja 1 orëshe	360 µg/m ³	Sekondare	110 µg/m ³
	Mesatarja 10 minutëshe	500 µg/m ³	Sekondare	400 µg/m ³
2	Okside të azotit dhe komponime të tjera të tij (NO _x).			
	Mesatarja vjetore arithmetike	60 µg/m ³	Primare&Sekondare	55 µg/m ³
	Mesatarja 4 orëshe	95 µg/m ³	Sekondare	92 µg/m ³
	Mesatarja 1 orëshe	250 µg/m ³	Primare	200 µg/m ³
3	Monoksid karboni (CO).			
	Mesatarja 24 orëshe	2 mg/m ³	Primare	1.8 mg/m ³
	Mesatarja 8 orëshe	10 mg/m ³	Primare	8 mg/m ³
	Mesatarja 1 orëshe	40 mg/m ³	Primare	35 mg/m ³
4	Lëndë e grimcuar e depozituar.			
	Mesatarja vjetore arithmetike	350 mg/m ³ /ditë	Primare&Sekondare	10 mg/m ³
4.1	Lëndë e grimcuar pezull LGP			
	Mesatarja vjetore arithmetike	140 µg/m ³	Primare&Sekondare	66 µg/m ³
	Mesatarja 24 orëshe	250 µg/m ³	Primare&Sekondare	200 µg/m ³
4.2	Lëndë e grimcuar < 10 µ (PM 10)			
	Mesatarja vjetore arithmetike	60 µg/m ³	Primare&Sekondare	50 µg/m ³
	Mesatarja 24 orëshe	150 µg/m ³	Primare&Sekondare	100 µg/m ³
4.3	Lëndë e grimcuar < 2.5 µ (PM 2.5)			
	Mesatarja vjetore arithmetike	15 µg/m ³	Primare&Sekondare	10 µg/m ³
	Mesatarja 24 orëshe	66 µg/m ³	Primare&Sekondare	50 µg/m ³

b. Intensiteti i zhurmave.

Nr.	Pajisja	Vlera e zhurmave.
1	Kamion	81 – 85 LeqdB (A) në distancën 15 metra.
2	Eskavator	76 – 78 LeqdB (A) në distancën 15 metra.
3	Kompresor I ajrit të ngjeshur,	76 – 79 LeqdB (A) në distancën 15 metra.

12. Plani i menaxhimit të mbetjeve.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së shfrytëzimit të vendburimit të mineralit të gipsit, gjenerohen dy lloje mbetjesh :

- a. Mbetje të ngurta teknologjike.
- b. Mbetje urbane.

Mbetjet e ngurta teknologjike përbëhet kryesisht prej argjilave dhe coprave të gipsit të përzjera me to. Këto lloj mbetjesh janë rezultat e kryerjes së punimeve për heqjen e mbulesës, të hapjes së rrygëve hyrëse e traseve prerëse si dhe gjatë kryerjes së operacioneve të punës për nxjerrjen e mineralit të gipsit. Duhet pranuar se subjekti ka një përvojë pozitive në administrimin e këtyre lloje mbetjesh. Me anë të mjeteve që disponon subjekti, ato çvendosen nga vendi i krijimit të tyre, në sheshin e depozitimit të mbetjeve brenda teritorit të objektit në pjesën juglindore të tij. Duke qënë pjesë e formacioneve përbërëse të këtij vendburimi ato pothuajse nuk ndikojnë në treguesit cilësor të truallit mbi të cilin janë depozituar. Problem i vlerësueshem për gjendjen e tyre në këtë venddepozitim janë marrje me vete e pluhurave përbërës nga erërat që fryjnë si dhe nga ujrat sipërfaqësorë që rrjedhin gjatë reshjeve.

Marrëveshja egzistuese me strukturat përkatëse të Bashkisë Belësh për përdorimin e këyre mbetjeve të ngruta teknologjike si shtresa ndërmjetëse mbuluese të mbetjeve urbane të kësaj bashkije, ka zvogëluar ndjeshëm sainsë e tyre të depozituar brenda teritorit të karrierës.

Gjithsesi drejtuesit e këtij subjekti vijojnë përpjekjet për të gjetur dhe bashkëpunuar me subjekte që merren me ndërtimin e rrugëve automobilistike, në përdorimin e këtij materiali si stabilizant të tyre.

Një pjesë e këtyre mbetjeve teknologjike, do të përdoren gjatë fazës së rehabilitimit të karrierës për mbushjen e pjesëve të caktuara të saj, si psh të shesheve të niveleve të poshme me qëllim krijimin e kushteve teknike të përshtatëshme për përdorimin e mëtejshëm të shtresave me dhé e argjila. Kështu do mund të krijohen në vijimi sipërfaqe të mbjella me pemë të ndryshme dhe sipërfaqe të gjelbëruara.

Këto mbetje janë objekt i Ligjit Nr 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar Shqiptar” dhe të Udhezimit Nr.3 datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqëve të dëmtuara nga aktiviteti minerar”.

Për të zbatuar këto kërkesa ligjore është hartuar plani i rehabilitimit të kësaj kariere si dhe plani i menaxhimit të mbetjeve minerare të gjeneruara nga veprimtaria minerare nga kjo karrierë.

Mbetjet urbane të krijuara gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije përbëhen kryesisht nga:

- ambalazhe të letrës e kartonit.
- Ambalazhe prej plastike e qelqi.
- Mbetje drunore e metalike
- Mbetje ushqimore etj.

Këto mbetje mblidhen në kazanë metalikë të vendosur në vende të caktuara Brenda teritorit të karrierës dhe largohen prej tyre në mënyrë periodike duke u dërguar në kazanët e mbetjeve urbane të vendosur nga Bashkia Belësh, në qëndrënmë të afërt të banuar.